

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN

***“PËR_PËRJASHTIMIN NGA EMËRIMI, ZGJEDHJA NË ORGANE
DREJTUESE DHE PUNËSIMIT NË FUNKSIONE PUBLIKE, SHTETËRORE DHE POLITIKE
TË ISH-FUNKSIONARËVE, NËPUNËSVE QË KANË USHTRUAR DETYRA DREJTUESE NË
PËRIUDHËN 28.11.1944 E DERI NË 8.12.1990”.***

Projektligji “ Për Përrjashtimin nga emërimi, zgjedhja në organe drejtuese dhe të punësimit në funksione publike, shtetërore dhe politike të ish – funksionarëve, nëpunësve që kanë ushtruar detyra drejtuese në periudhën 28.11.1944 -08.12.1990” përcakton dhe rregullon masat që duhen ndërmarrë për çrrënjosjen e trashëgimisë së sistemit totalitar komunist, të krimeve të komunizmit në Republikën e Shqipërisë të cilët nuk u ndëshkuan dhe dënuan, duke përjashtuar nga emërimi, zgjedhja në organet drejtuese dhe punësimi në funksionet publike, shtetërore dhe politike ish-funksionarët, nëpunësit që kanë ushtruar detyra drejtuese në periudhën 28.11.1944 - 08.12.1990.

Ky projektligj synon të shtrijë veprimtarinë e tij për të gjithë ish – funksionarët, nëpunësit që kanë ushtruar detyra drejtuese në periudhën 28.11.1944 – 08.12.1990, me shtetësi shqiptare dhe që ndodhen brenda territorit të Republikës së Shqipërisë konkretisht: Anëtarë të Partisë Komuniste të Shqipërisë (PKSH) dhe të Partisë Punës së Shqipërisë; Ish - funksionarët e Sistemit Komunist; Ish- gjyqtarë, ish-prokurorë, ish-hetues, ish-Oficerë të Sigurimit të Shtetit Komunist, dhe ish- bashkëpunëtorë të Sigurimit të Shtetit (Spiunë Sigurimi); Të shkolluarit dhe të kualifikuarit në shkollat e larta politike të Partisë Punës së Shqipërisë (PPSH-së) dhe të Sigurimit të Shtetit të Mbrotjtjes në ish-vendet e traktatit të Varshavës; Ish-anëtarët ose bashkëpunëtorët e Shërbimeve të Inteligjencës së ish-vendeve të Traktatit të Varshavës.

Në funksion të kësaj, vlen për t’u përmendur se në datën 25.01.2006 Asambleja Parlamentare e KE-së votoi Rezolutën nr. 1481 “Mbi nevojën për dënimin ndërkombëtar të krimeve të regjimeve totalitare komuniste”.

Lidhur me këtë fakt, Delegacioni shqiptar votoi pro asaj Rezolute, e cila u miratua nga Parlamenti Shqiptar në tetor të vitit 2006.

Gjithashtu, vlen për t’u theksuar se, Rezoluta e parë e KE-së, ishte bërë qysh në vitin 1996 “Për masat që duheshin marrë për çrrënjosjen e trashëgimisë së sistemit totalitar komunist. Siç u evidentua edhe në këto rezoluta, krimet e komunizmit në vendet ish – komuniste, veçanërisht në

Shqipërinë komuniste staliniste, nuk ishin dënuar dhe ndëshkuar, siç u dënuan krimet e nazifashizmit në Europë.

Në vitin 2010 u themelua nga Parlamenti i Republikës së Shqipërisë “Instituti i studimit të krimeve dhe pasojave të komunizimit”.

Pra, në funksion të kësaj, ky projektligj është sa i nevojshëm, aq edhe i domosdoshëm, sepse lidhet drejtpërsëdrejti me çrënjosjen e sistemit totalitar komunist dhe trashëgimiësë së kalbur që ka lënë ai regjim nga pas.

VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE

Ky projektligj nuk synon përafrimin me legjislacionin e BE-së.

VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji hartohet në mbështetje të neneve 81 pika 1, të Kushtetutës dhe nenit 68 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë. Projektligji është në përputhje me Kushtetutën.

RAPORTI BUXHETOR I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE

Projektligji nuk parashikon efekte financiare në buxhetin e shtetit.

DEPUTETËT PROPOZUES